

Parimet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të gjykatave ndërkombëtare të arbitrazheve për investimet _____

_____ *Dr. Evelina Çela* _____

_____ *Msc. Arfjona Kocibellinj* _____

Abstrakt

Ky artikull ka të bëjë me parimet kryesore të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në fushën e investimeve nga gjykatat e arbitrazhit ndërkombëtar të përzier si dhe me veprimtarinë e procedurave të këtyre gjykatave, problematikat e tyre, duke analizuar: zhvillimin, statusin aktual dhe mundësitë e rritjes së efektivitetit të secilit prej tyre.

Parimet e procedurave të arbitrazhit ndërkombëtar përfaqësojnë norma, të cilat janë një sistem rregullator bazë, të njohura tashmë dhe pranuar botërisht për sa i përket procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në nivel ndërkombëtar. Në këtë këndvështrim kërkohet një diskutim dhe analizë e detajuar duke filluar nga momenti i rritjes së numrit të investimeve (të pambrojtura) deri tek arritjet e ditëve të sotme dhe rritja e numrit të marrëveshjeve bilaterale të këtyre arbitrazheve për mbrojtjen dhe promovimin e mëtejshëm të investimeve të huaja.

Fjalët kyçe: *mosmarrëveshje të investimeve, arbitrazhe të përziera, parimet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.*

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në arbitrazhet ndërkombëtare, ku personat privat kanë të drejtën e aksesit (arbitrazhet ndërkombëtare të përziera), bazohet në parime të ngjashme me parimet e arbitrazhit ndërkombëtar publik. Parimet e procedurave të arbitrazhit ndërkombëtar përfaqësojnë në vetvete normat e mbarënjohura të së drejtës publike ndërkombëtare të një rëndësie themelore për funksionimin e arbitrazhit ndërkombëtar të përzier.

Pavarësisht faktit, se në të drejtën ndërkombëtare nuk egziston ndonjë marrëveshje uniform ndërqeveritare, që të përmbante një listë të parimeve bazë të procedurës ndërkombëtare të arbitrazhit, nëpërmjet praktikës gradualisht janë zhvilluar rregulla themelore procedurale të përbashkëta për të gjitha arbitrazhet e përziera, duke përfshirë procedurën për rekurs në arbitrazh, organizimin e seancave dëgjimore, si dhe rregullat e zbatimit të vendimeve të marra nga gjykatat ndërkombëtare të arbitrazhit të përzier. Duke filluar nga shekulli XX, praktika e arbitrazhit ka zhvilluar parime të qëndrueshme të procedurave të arbitrazhit ndërkombëtar të përzier.

Në parimet e procedurave të arbitrazhit ndërkombëtar të përzier hyjnë: Parimi i aksesit të lirë në një gjykatë arbitrazhi, parimi i mirëbesimit, parimi i barazisë procedurale të palëve, parimi i kundërshtimit, parimi i optimalitetit, parimi i kolegialitetit, parimi i sigurisë ligjore, parimi i konfidencialitetit. Nga fundi shekullit XX veprimtaria e investimeve bëhet pjesë përbërëse e ekonomisë së secilit shtet ku fillon të rritet numri i marrëveshjeve bilaterale (BIT, bilateral investment treaty) për mbrojtjen dhe promovimin e investimeve të huaja, të cilat ofrojnë mundësinë e aksesit të konflikteve ndërmjet investitorëve dhe shtetit në arbitrazhe ndërkombëtare të përziera. E gjithë kjo çoi në një rritje të konsiderueshme të numrit të mosmarrëveshjeve në fushën e investimeve, të shqyrtuara nga arbitrazhi ndërkombëtar i përzier. Dhe disa nga parimet themelore të veprimtarisë së arbitrazhit ndërkombëtar të përzier filluan të pengojnë zhvillimin e një praktike koherente dhe konsistente të mosmarrëveshjeve në fushën e investimeve.

1. Parimi i aksesit të lirë arbitrazh

Procedura e arbitrazhit ndërkombëtar mund të kryhet vetëm mbi baza reciproke. Parimi mbi bazën e të cilit arbitrazhi është vullnetar, do të thotë se mosmarrëveshjet, ku njëra nga palët është një shtet ose një organizatë ndërkombëtare, dhe pala tjetër - është një person privat nuk mund të paraqiten në arbitrazh pa pëlqimin e palëve në konflikt. Në vendimin *Larsen v. Hawaiian Kingdom* arbitrat e Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit¹ kanë konstatuar se arbitrazhi i përzier ndërkombëtar nuk mund të ushtroj juridiksion mbi palën, e cila nuk është palë në procedurë². Praktika e arbitrazhit ndërkombëtar të përzier njihet dy mënyra në të cilat palët mund të shprehin pëlqimin e tyre për mosmarrëveshjen.

Së pari, ajo është rezultat/prodhim i një marrëveshje apo kompromisi³ të veçantë (*compromis d'arbitrage*), sidomos kur kemi të bëjmë me një mosmarrëveshje, që

¹ www.icj-cij.org/docket/files/19/4761.pdf

² Merrills J. G. The Contribution of the Permanent Court of Arbitration to international law 1999-2009. Summaries of Awards 1999-2009. F.10. The Hague: T. M. C. Asser Press 2010. F. 53.

³ Malcolm N. Shaw. International Law. 6th Edition. Cambridge. 2008. F.1051.

është *post facto*, dhe e cila përfundon me marrjen e vendimit të arbitrazhit. **Së dyti**, një kompromis i tillë mund të shprehet në një kontratë mes individit dhe shtetit, për shembull, në kontratën e investimeve apo marrëveshjen e konçesionit. Zhvillimi i të drejtës moderne ndërkombëtare të investimeve do të thotë se çdo marrëveshje bilaterale, domosdoshmërisht fikson mundësinë për çdo investitor të një shteti anëtar në këtë marrëveshje, në rast të një konflikti, të ketë të drejtën e zgjidhjes në arbitrazhin ndërkombëtar me padinë kundër një shteti tjetër. Me fjalë të tjera, çdo shtet-palë në BIT parapakisht bie dakord për zgjidhje në arbitrazh për çdo lloj konflikti me këdo investitor të një shteti tjetër palë të marrëveshjes. Nga pikëpamja e arbitrazheve ndërkombëtare të investimeve (ky pozicion është sanksionuar në vendime të shumta), dispozitat e BIT përfaqësojnë një propozim (ofertë), e cila mund të merret (pranohet) nga çdo investitor në rast të një mosmarrëveshjeje në të ardhmen. Investitori, në rast domosdoshmërie të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në arbitrazhin ndërkombëtar të investimeve, e merr këtë propozimin për procedurë arbitrazhi, thjesht duke aplikuar në këtë gjykatë me një kërkesë për fillimin e procedurës, por duke cituar dispozitat e BIT⁴.

2. Parimi i besimit të mirë

Parimi i besimit të mirë siguron në nivel të duhur procedura të tilla si: aksesit në arbitrazh, një proces të drejtë si dhe ekzekutimin e vendimit të marrë⁵. Bin Cheng konsideron parimin e besimit të mirë si «parimin themelor të çdo sistemi ligjor»⁶. Në vendimin e vet në rastin e *Metzger & Co. Case* të vitit 1900, arbitri vendosi: «ndershmëria është një parim jo më pak i rëndësishëm për një shtet drejt përmbushjes së detyrimeve të veta kundrejt individëve dhe subjekteve juridikë sesa kundrejt shteteve»⁷.

Baza e kësaj force tërheqëse të arbitrazheve ndërkombëtare të investimeve përbëhet nga dy faktorë: mundësia e investitorëve të huaj për tu drejtuar direkt në arbitrazh ndërkombëtar, (një rregull i tillë u konfirmua në vendimin e arbitrave të ICSID-it në rastin e *Siemens v. Argentina*⁸, dhe prania e garancive për zbatimin e vendimeve të marra prej arbitrazhit). Në pajtim me nenin 54 të Konventës «Për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve ndërmjet shteteve dhe shtetasve të

⁴ Eureko B.V. v. The Slovak Republic <http://www.pca-cpa.org>

⁵ A.H.A. Soons, International Arbitration: Past and Prospects, Kluwer Academic Publishers, The Netherlands. 1990. F. 160. Shiko gjithashtu: Malcolm N. Shaw. International Law. 7th Edition. Cambridge. 2014.

⁶ Bin Cheng, General principles of law as applied by international courts and tribunals. 2006. F. 105.

⁷ United States, Dept. of State Charles Irving Bevans. Treaties and other International Agreements of the United States of America 1776-1949. 1971. F. 649

⁸ http://icsid.worldbank.org/ICSID/FrontServlet?requestType=CasesRH&actionVal=showDoc&docId=DC1171_En&caseId=C5

shteteve të tjera» e vitit 1965, një shtet kontraktues duhet të njohë një vendim të dhënë nga arbitrat e ICSID-it, dhe ta zbatoj atë sikur të ishte një vendim i formës së prerë të një gjykate kombëtare të atij Shteti.

3. Parimi i barazisë procedurale të palëve

Ky parim është themelor për sa i përket organizimit të një procesi arbitrazhi ndërkombëtar, i cili shprehet në barazinë themelore të palëve në konflikt dhe «rrjedh nga vetë natyra e së drejtës ndërkombëtare»⁹. Në veprimtarinë e gjykatave të arbitrazheve ndërkombëtare, ky parim realizohet nëpërmjet sigurimit të të drejtave të barabarta të palëve në zgjedhjen e arbitrave për shqyrtimin e mosmarrëveshjes¹⁰ si dhe nëpërmjet përcaktimit në rregulloren e procedurës të të drejtave të barabarta të palëve përpara gjykatës në mbrojtjen e interesave të tyre dhe të masave mbrojtëse procedurale të barabarta¹¹.

Neni 52 i Konventës “Për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve ndërmjet shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera” e vitit 1965, parashikon anulimin e vendimit të arbitrazhit, në mënyrë të veçantë, për arsyet e mëposhtme: përbërja e Tribunalit nuk është caktuar në mënyrën e duhur në pajtim me ligjin, kur ka tejkaluar qartësisht kompetencat e veta, kur ka pasur korrupsion nga ana e një anëtari të Tribunalit, kur ka patur një largim serioz nga rregullat themelore të procedurës dhe kur vendimi nuk ka arritur të tregoj arsyet mbi të cilat është bazuar¹². Sipas përcaktimit të Ch. Schreuer: kur Tribunali nuk i jep mundësinë njëjës prej palëve për të shprehur pozicionin e saj, atëhere kjo përbën një largim serioz nga rregullat themelore të procedurës së ICSID-it¹³.

Në rrjedhën e procedurës në rastin e *Giovanna A Beccara and Others v. The Argentine Republic* arbitrat në mënyrë të përsëritur ndërmorën rregulla procedurale në lidhje me procesin dhe pranueshmërinë e dokumentave (pranueshmërinë e dokumentave të reja), organizimin e seancave dëgjimore dhe pjesëmarrjen në to, marrjen në pyetje të dëshmitarëve si dhe zbulimin e informacioneve nga aplikantët. Gjatë procedurës i pandehuri është paraqitur me një propozim për përjashtimin e dy arbitrave dhe procedura e kësaj çështje u pezullua (më vonë Tribunali u rivendos)¹⁴. Ky parim është në lidhje të ngushtë me parimin e kundërshtimit, realizimi i të cilit është i mundur vetëm kur kemi barazi ligjore të palëve në proces.

⁹ Shinkarekaya G.G. International court procedures. M. 1992. F. 154.

¹⁰ Nemirovskij. About International Court. «The Journal of jurisprudence communication» Nr.4. 1898. F. 85.

¹¹ ICSID Reports: James Crawford, Karen Lee, Elihu Lauterpacht 2005. F. 231.

¹² https://icsid.worldbank.org/ICSID/StaticFiles/basicdoc/CRR_English-final.pdf

¹³ Ch. Schreuer, The ICSID Convention: A Comentary, Cambridge University Press. 2001. F. 765.

¹⁴ <http://www.investmenttreatynews.org/cms/news/archive/2010/03/10/icsid-tribunal-applies-ad-hoc-approach-to-confidentiality-in-arbitral-proceeding.aspx>

4. Parimi i kundërshtimit

Parimi i kundërshtimit përcakton aftësinë e palëve për të mbrojtur pozicionin e tyre ligjor. Që do të thotë, secila palë duhet të vërtetoj ato fakte mbi të cilat ka mbështetur kërkesat e parashtruara. Parimi i kundërshtimit përcakton gjithashtu rolin e gjykatës së arbitrazhit në përcaktimin e dispozitave relevante për shqyrtimin e çështjeve. Arbitrat kanë autoritetin i cili rrjedh nga vet funksionet gjyqësore, që vendosjen e drejtësisë ta kërkojnë me të gjitha mundësitë e mundshme. Arbitri gjithmonë mund tu kërkoj palëve paraqitjen e të gjitha akteve, dokumentave dhe shpjegimet e nevojshme si dhe të thërrasë dëshmitarë, të kryej ekzaminime apo hetime. Arbitri nuk mund ta bëj këtë vetëm nëse shprehimisht ndalohe nga palët e mosmarrëveshjes¹⁵.

Arbitrat e ICSID-it në vendimin e çështjes *AAP v. Sri Lanka* deklaror: “Pala duhet që, jo vetëm të japë dëshmi në mbështetje të kërkesave të saj, por edhe për të provuar vërtetësinë e tyre, në të kundërt këto dëshmi mund të mbeten jashtë vëmendjes»¹⁶. Në një vendim të dhënë në rastin e *Tradex v. Albania*, kundërshtimi pranohet si “parim i përgjithshëm i procedurës ndërkombëtare»¹⁷. Zbatimi i parimit të kundërshtimit është i lidhur gjithashtu me parimin e optimalitetit.

5. Parimi i optimalitetit

Në përputhje me parimin e optimalitetit, palët në çdo fazë të procesit mund të disponojnë të drejtat e tyre subjektive procedurale, të cilat janë: të njihen me materialet e çështjes, të marrin kopje të dokumenteve që disponohen për çështjen, të marrin pjesë në procedurat gjyqësore apo të paraqesin kundërshtime. Palët mund ti japin fund zgjidhjes së çështjes me një marrëveshje paqësore në çdo fazë të procesit¹⁸. Praktika e ICSID-it njeh disa raste, të përfundimit të çështjeve me anë të marrëveshjeve paqësore ndërmjet palëve. Në pajtim të nenit 43 të Rregullores së ICSID-it, palët mund të bien dakord për të ndërprerë mosmarrëveshjen përpara se arbitrazhi të marrë vendimin. Marrëveshje të tilla paqësore janë nënshkruar

¹⁵ Jean-François Poudret, Sébastien Besson. Comparative law of international arbitration. 2007, F. 338-339

¹⁶ http://icsid.worldbank.org/ICSID/FrontServlet?requestType=CasesRH&actionVal=showDoc&docId=DC677_En&caseId=C140

¹⁷ <http://icsid.worldbank.org/ICSID/FrontServlet?requestType=CasesRH&actionVal=showDoc&docId=DC533&caseId=C148>

¹⁸ Alan Redfern, Law and practice of international commercial arbitration. 2004., Malcolm N. Shaw. International Law. 7th Edition. Cambridge. 2014.

nga palët në konflikt në këto raste: *GGPC v. Nigeria* në vitin 1980¹⁹, *I Goetz v. Burundi* në vitin 1999²⁰, *WRB v. Grenada* në vitin 1998²¹, *Compagnie Francaise pour le Developpement des Fibres Textiles v. Cote d'Ivoire* në vitin 2000²², *Lemire v. Ukraine* në vitin 2000²³, *Astaldi v. Honduras* 2000²⁴.

6. Parimi i kolegjalitetit

Parimi i kolegjalitetit do të thotë se të gjithë anëtarët e komisionit të arbitrazhit kanë mundësi të barabarta për të marrë pjesë në vendimmarrje, pavarësisht nëse është arbitër i zgjedhur nga pala apo në rastin kur është një arbitër i përgjithshëm (kryearbitër)²⁵. Parimi i kolegjalitetit u formua menjëherë pas fillimit të veprimtarisë së arbitrazheve ndërkombëtare të përziera²⁶. Vendimi duhet të nënshkruhet nga të gjithë arbitrat, dhe në rast të mospajtimit të njërit prej tyre me vendimin e përgjithshëm, ai mund të parashtroj mendimin e tij të veçantë²⁷. Kështu, mendimi kundërshtues i arbitrit, u sygjera nga Profesor Georges Abi-Saab në çështjen e përmendur më lart *Giovanna A Beccara and Others v. The Argentine Republic*²⁸. Që prej vitit 1996, arbitrat e ICSID-it kanë shprehur mendime të veçanta në më shumë se njëzet herë²⁹.

Një nga shembujt më të njohur të arbitrazheve kolegjiale të përziera mund të përmendim Tribunalin për pretendimet mes Iranit dhe Shteteve të Bashkuara³⁰, i cili ishte krijuar me marrëveshjen e Algjerisë për zgjidhjen e konfliktit në vitin 1981³¹.

¹⁹ *Guadalupe Gas Products Corporation v. Nigeria* (ICSID Case No. ARB/78/1).

²⁰ Taida Begic. *Applicable law in international investment disputes*. 2005. F. 32, ICSID Rep. Vol 6.

²¹ <http://icsid.worldbank.org/ICSID/FrontServlet?requestType=CasesRH&actionVal=showDoc&docId=DC536&caseId=C15>

²² Antonio R. Parra, *The History of ICSID*. Oxford University Press, 2012. F.209. <http://www.worldbank.org/afr/wps/wp62.pdf>

²³ http://icsid.worldbank.org/ICSID/FrontServlet?requestType=CasesRH&actionVal=showDoc&docId=DC569_En&caseId=C165

²⁴ Antonio R. Parra, *The History of ICSID*. Oxford University Press, 2012. F. 264.

²⁵ Michael W. Bühler, Thomas H. Webster, *Handbook of ICC arbitration: commentary, precedents, materials.*, 2005. F. 309; Jackson H. Ralston. *International Arbitration from Athens to Locarno*. 2004. F. 178.

²⁶ Michael W. Bühler, Thomas H. Webster, *Handbook of ICC arbitration: commentary, precedents, materials.*, 2005. P. 309; Jackson H. Ralston. *International Arbitration from Athens to Locarno*. 2004. F. 178.

²⁷ Elizabeth Whitsitt. *An ICSID Tribunal splits over whether to hear ancillary claims in dispute over unpaid gas deliveries 2010*.

²⁸ Erik de Brabandere, *Investment treaty arbitration as Public International Law 2014*. F. 156.

²⁹ <http://icsid.worldbank.org>

³⁰ Collier John, Vaughan Lowe. *The settlement of disputes in international law: institutions and procedures*. 2000. F. 73, Julian D.M. Lew Loukas A. Mistelis, Stefan Kröll. *Comparative international commercial arbitration 2003*. F. 42.

³¹ «Marrëveshja e Algjerisë» përbëhet nga dy Deklarata: Deklarata e qeverive demokratike dhe ajo e Republikës popullore të Algjerisë (deklarata e Përgjithshme) dhe Deklarata e qeverive demokratike dhe

Sipas nenit 37 të Konventës «Për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve ndërmjet shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera», arbitrazhi duhet të përbëhet ose nga një arbitër i vetëm ose nga një numër tek arbitrash të caktuar prej palëve. Në mungesë të marrëveshjes ndërmjet palëve për numrin e arbitrave, atëherë gjykata do të përbëhet prej tre vetash (dy arbitra do të zgjidhen prej palëve, kurse i treti do të zgjidhet nga Presidentit të gjykatës, kandidaturë për të cilën palët duhet të shprehin dakortësinë e tyre).

7. Parimi i sigurisë juridike

Format dhe metodat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të investimeve në përputhje me të drejtën ndërkombëtare zakonore, marrën një përfundim të veçantë ligjor në marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale të investimeve. Kontratat/marrëveshjet e investimeve janë të projektuara për të siguruar mbrojtje ligjore sipas së drejtës ndërkombëtare, si dhe të kenë qasje në mënyrat ndërkombëtare të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në rast se ato do të lindin.

Marrëveshjet bilaterale për investimet (BIT) rregullojnë ato çështje të cilat investitorët e huaj i konsiderojnë të rëndësishme për veten e tyre, duke synuar krijimin e një regjimi ligjor më të besueshëm dhe për këtë arsye të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm. Numri i BIT filloi dukshëm të rritet që në fillim të viteve 90 të shekullit XX, po ashtu edhe numri i shteteve palë në BIT (në fund të shekullit XX, numri i BIT arriti në 1100, kurse deri në vitin 2014 kishte më shumë se disa herë). Në vitet e fundit, numri i rasteve të dërguara në arbitrazh është rritur ndjeshëm³².

Rritja e numrit të mosmarrëveshjeve të dërguara për shqyrtim në arbitrazh çoi gjithashtu në një rritje të numrit të arbitrave të përfshir për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve. Arbitrat në këtë situatë, duke interpretuar dhe zbatuar normat e të drejtës ndërkombëtare publike, shpesh vinin në përfundime kundërshtuese, duke formuar kështu një praktikë të diskutueshme. Kështu, në vend që të ofronin siguri ligjore dhe qëndrueshmëri, të cilat në vetvete japin rritje të parashikueshmërisë dhe besueshmërisë për investitorët e huaj dhe shtetet, arbitrat krijuan (një interpretim dhe aplikim jo-uniform) në lidhje me kuptimin e normave të së drejtës ndërkombëtare, e cila ka çuar në një mungesë të një praktike gjyqësore logjike. Në këtë drejtim, Sekretari i Përgjithshëm i ICSID-it vuri në dukje se «mundësia për vendime të papajtueshme në thelb për të njëjtat çështje është e dukshme»

ajo e Republikës popullore të Algjerisë për zgjidhjen e pretendimeve ndërmjet Qeverisë së Shteteve të Bashkuara dhe Qeverisë së Republikës Islamike të Iranit (Deklaratës për zgjidhjen e humbjeve, (Declaration on the settlement of losses)), në bazë të së cilës u themelua Tribunali për pretendimet mes Iranit dhe Shteteve të Bashkuara për zgjidhjen e konflikteve si dhe të pesë Marrëveshjeve teknike. www.iusct.org/general-declaration.pdf

³² Deri në ditët e sotme nën shqyrtimin e gjykatës së ICSID-it janë depozituar 549 çështje arbitrazhi. www.icsid.worldbank.org

dhe se vendimet e arbitrazheve të investimeve demonstrojnë një valë vendimesh kontradiktore. Në të ardhmen, këto vendime mund jo thjesht të kundërshtojnë njëra-tjetrën (papajtueshmëri e dyfishtë), por shtrirja e gjykimeve të papajtueshme mund të jetë e trefishtë dhe katërfishtë³³.

Si shembull mund të sjellim vendimin e marrë nga arbitrat e arbitrazheve të Londrës dhe Stokholmit në çështjen e *Lauder/CME*³⁴. Në vitin 1990, z. Lauder (biznesmen Amerikan) dhe partneri i tij (bashkë-investitor), së bashku me z. Iron (shtetas Çek) themeluan një sipërmarrje të përbashkët në Republikën Çeke (stacion televiziv privat) duke ushtruar aktivitetin e vet në bazë të licencës së marrë në përputhje me legjislacionin kombëtar të Republikës Çeke³⁵. Në vitin 1995 Republika Çeke miratoi një ligj, dispozitat e të cilit ndryshojnë procedurën për licencimin e veprimtarisë së ndërmarrjeve në fushën e transmetimeve. Në vitin 1999, z. Lauder inicioi procedurën e arbitrazhit mbi bazën e marrëveshjes BIT SHBA-Çeki në arbitrazhin e Londrës, kurse partneri i tij (bashkë-investitor) në arbitrazhin e Stokholmit në bazë të marrëveshjes BIT Hollandë-Çeki. Arbitrat në Londër pranuan se dispozitat e ligjit të ri çek nuk ishin diskriminuese në lidhje me investitorët e huaj, kurse arbitrat në Stokholm, vendosën të kundërtën, i njohën dispozitat e ligjit çek si diskriminuese ndaj investitorëve të huaj dhe i konsideruan veprimet e qeverisë çekë si një privatizim të fshehur.

Rritja e shpejtë e numrit të vendimeve të arbitrave për çështjet e aplikimit të BIT çoi qartësisht në atë, që në vitet e fundit u shfaqën të meta të cilat lejuan disa autorë për ta përshkruar gjëndjen si një «krizë legjitimiteti» ose «privatizim të së drejtës ndërkombëtare» prej arbitrave privat³⁶. Me fjalë të tjera, nuk u krijua një praktikë e qëndrueshme e interpretimit të normave të së drejtës ndërkombëtare publike, e cila sot është një mangësi thelbësore e arbitrazhit ndërkombëtar të përzier. Përveç kësaj, gjithashtu duhet ti kushtojmë vëmendje edhe kostos së lartë të shqyrtimit të çështjes (rreth 1-2 milionë dollarë vetëm për vitin e parë), si dhe afateve të kohëzgjatjes së shqyrtimit të çështjeve (rreth 3-5 vjet). Me fjalë të tjera, mungesa e qartësisë së kuptimit të normave ligjore dhe praktikës së zbatimit të tyre, mund të bëhet një kërcënim konkret për marrëdhëniet ndërkombëtare të fushës së investimeve.

Në këtë drejtim, praktika ka treguar se «në çdo sistem ligjor në të cilin vendime diametralisht të kundërta që janë ligjërish të pranuar, nuk mund të ekzistojnë për një kohë të gjatë». Kjo minon ndjenjën e drejtësisë dhe paanësisë. Duke patur

parasysh se çështjet ligjore janë baza e procedurës së arbitrazhit, shkencëtarët duhet të zgjidhin problemet themelore të cilat qëndrojnë në krizën e legjitimitetit³⁷.

Arbitrazhi për investimet duhet ti drejtoj përpjekjet drejt një kuptimi uniform, të interpretimit dhe zbatimit të normave të së drejtës ndërkombëtare publike. Për këtë, mund të duhet të ngrihet një organ arbitrazhi apeli, i cili mund të shqyrtonte mosmarrëveshjet në thelb. Kështu, vendimi i tij do të kishte vlefshmëri më të madhe ligjore (argumentuese), nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, vendimeve të tij do të detyroheshin t'i kushtoin vëmendje të gjitha arbitrazhet e tjera të investimeve, në marrjen e një vendimi konkret. Finalizimi i vendimit në ditët e sotme nuk është më një cilësi tërheqëse e arbitrazhit ndërkombëtar të përzier, por përkundrazi është një mungesë e saj. Përpara organit të Apelit qëndrojnë dy detyra: identifikimi i gabimeve të dukshme në interpretimin dhe zbatimin e të drejtës ndërkombëtare dhe krijimi i një jurisprudence (gjithëpërfshirëse) të konsoliduar.

Një rast shembulli të suksesshëm të një organi apeli mund të sjellim Organin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të OBT-së (World Trade Organisation), sipas të cilit «pranimi i raporteve të panelit të arbitrazhit është një pjesë e rëndësishme e jurisprudence-së së GATT (General Agreement on Tariffs and Trade) dhe shpesh merren në konsideratë nga grupet e paneleve të arbitrazhit. Anëtarët e OBT-së presin që paneli do të veprojë në të ardhmen në të njëjtën frymë, prandaj dhe raportet duhet të merren parasysh atje ku është e përshtatshme»³⁸.

Deri më sot, asnjë arbitrazh i përzier nuk ka potencialin për të eliminuar mospërputhjet në vendimet e arbitrazheve për investimet. Por, në perspektivë, organ apeli mund të ishte ICSID-i.

8. Parimi i konfidencialitetit

Në shumicën e rasteve, vendimet e marra nga arbitrazhet e përziere janë konfidenciale dhe nuk janë në dispozicion për studim, si nga shkencëtarët e jurisprudence-së ashtu edhe nga arbitrat e tjerë. Rëndësia themelore e publikimit të vendimeve të arbitrazheve vjen nga fakti se akumulimi i zgjidhjeve identike ose të ngjashme, aftëson për të gjeneruar një fenomen të imitimit, që do të punojë vetëm në rast të përsëritjeve të vendimeve të njëjta për çështje të ndryshme. Në qoftë se arbitrazhi është një mundësi efektive për të zgjidhur, në veçanti, mosmarrëveshjet e investimeve, atëherë është e nevojshme tu ofrojmë individëve dhe shteteve një mundësi të një parashikueshmërie të madhe të rezultatit të çështjeve. Nga ana tjetër, një njohuri e mirë e praktikës së arbitrazhit do të lejojë që të kemi një kuptim

³³ Susan D. Franck // The Legitimacy Crisis in Investment Treaty Arbitration: Privatizing Public International Law through Inconsistent Decisions. Vol. 73., FORDHAM L. REV. 2005. F. 1582.

³⁴ Po aty. F. 1558-1559. Shiko dhe: Waibel M. The backlash against investment arbitration: perceptions and reality 2010. F. 118.

³⁵ Lauder me partnerin e tij ushtuan investime jo direkte në ekonominë e Republikës Çeke.

³⁶ Susan D. Franck // The Legitimacy Crisis in Investment Treaty Arbitration: Privatizing Public International Law through Inconsistent Decisions. Vol. 73., FORDHAM L. REV. 2005. F. 1521.

³⁷ Vandeveldt J. Kenneth, The growth of bilateral investment treaties and their impact on foreign investment in developing countries // Int'l Law. 1990.

³⁸ WTO Appellate Body Report on United States - Import prohibition of certain shrimp products, WT/DS58/AB/RW (Oct. 22, 2001) F. 108. www.wto.org

të qartë të realitetit dhe të përparësive të arbitrazhit. Kjo, natyrisht, nuk do të thotë se arbitrat duhet të privohen nga liria në mënyrën e zgjidhjes së çdo rasti konkret.

Si një sygjërim për të zgjidhur problemin e legjitimitetit të vendimeve të arbitrazheve, mund të supozojmë se zgjidhja e mosmarrëveshjeve në arbitrazhet ndërkombëtare, (ku kanë të drejtën e aksesit personat privat), të ndërtohet në përputhje me parimin e transparencës. Transparenca ka një rëndësi të madhe në se rregullat e rëndësishme për ekonominë dhe zbatimin e tyre në praktikë është në dispozicion për të gjithë, dhe kur nuk krijohen pengesa për pjesëmarrësit e marrëdhënieve në fushën e investimeve për marrjen e informacioneve³⁹.

Në veçanti, institucionet e arbitrazheve mund të marrin në konsideratë çështjen për sa i përket miratimit të një protokollit që do të ofronte mundësinë për të botuar vendimin e marrë. Ose, ndoshta, krijimi i grupeve të punës, anëtarët e të cilëve mund të jenë si arbitra nga praktika ashtu edhe zyrtarëve qeverie. Rekomandimet e këtyre grupeve të punës gjithashtu mund të formojnë një bazë për rregullat e arbitrazhit.

Për shembull, ICSID-i mund të ndryshonte rregullat e veta shtesë neni 53 (3) për të treguar se në rastin e një marrëveshje arbitrazhi për investim, palët bien dakord për publikimin e vendimit. Megjithatë, në praktikë mund të ndeshim në një sërë vështirësish. Në veçanti, rishikimi i rregullave shtesë të ICSID-it do të jetë i kufizuar nga kërkesat e Konventës «Për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve ndërmjet shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera». Kurse Rregullorja e UNCITRAL-it nuk ka ndryshuar që prej vitit 1978, ku në nenin 32§5 parashikohet se vendimet e arbitrazheve nuk duhet të publikohen pa pëlqimin e palëve, dhe kjo mund të përbëjë një problem, duke qënë se rishikimi apo ndryshimi i Rregullores kërkon pëlqimin e shteteve⁴⁰.

Bibliografia

1. Antonio R. Parra, *The History of ICSID*. Oxford University Press, 2012.
2. Alexis Mourre, Castaldi Mourre & Partners // *Arbitral Jurisprudence in International Commercial Arbitration: The Case For A Systematic Publication Of Arbitral Awards In 10 Questions...*2009.
3. A.H.A. Soons (ed.) *International Arbitration: Past and Prospects*, Kluwer Academic Publishers, The Netherlands. 1990.
4. Alfred Redfern, *Law and practice of International commercial arbitration*. 2004.
5. Alexis Mourre, Castaldi Mourre & Partners // *Arbitral Jurisprudence in International Commercial Arbitration: The Case For A Systematic Publication Of Arbitral Awards In 10 Questions...*2009.
6. Bin Cheng, *General principles of law as applied by international courts and tribunals*. 2006.

³⁹ Ian Brownlie, *Principles of Public International Law*, 8th Ed. 2012.

⁴⁰ Ian Brownlie, *Principles of Public International Law*, 6th Ed. 2003.

7. Collier John, Vaughan Lowe. *The settlement of disputes in international law: institutions and procedures*. 2000.
8. Ch. Schreuer, *The ICSID Convention: A Comentary*, Cambridge University Press. 2001.
9. Charles Irving Bevans, *United States Dept. of State, Treaties and other International Agreements of the United States of America 1776-1949*. 1971.
10. Erik de Brabandere, *Investment treaty arbitration as Public International Law* 2014.
11. Elizabeth Whitsitt. *An ICSID Tribunal splits over whether to hear ancillary claims in dispute over unpaid gas deliveries*, 2010.
12. Fahrutdinov I. Z. *International investment law: theory and practice issues*. . 2005.
13. Ian Brownlie, *Principles of Public International Law*, 6th Ed. 2003.
14. Ian Brownlie, *Principles of Public International Law*, 8th Ed. 2012.
15. Jean-François Poudret, Sébastien Besson. *Comparative law of international arbitration*. 2007.
16. Ileana M. Smeureanu, *Confidentiality in international arbitration*, Kluwer Law International, The Netherlands. 2011.
17. James Crawford, Karen Lee, Elihu Lauterpacht, *ICSID Reports: 2005*.
18. Julian D. M., Lew Loukas A. Mistelis, Stefan Kröll. *Comparative international commercial arbitration* 2003.
19. John O'Brien. *International Law*. 2002.
20. Malcolm N. Shaw. *International Law*. 6th Edition. Cambridge. 2008.
21. Malcolm N. Shaw. *International Law*. 7th Edition. Cambridge. 2014.
22. Nemirovskij. *About International Court*. «The Journal of jurisprudence communication» Nr.4.1898.
23. Susan D. Franck // *The Legitimacy Crisis in Investment Treaty Arbitration: Privatizing Public International Law through Inconsistent Decisions*. Vol. 73., *FORDHAM L. REV.* 2005.
24. Shinkareckaya G.G. *International court procedures*. . 1992.
25. Thomas H. Webster, *Handbook of ICC arbitration: commentary, precedents, materials*., Michael W. Bühler, 2005.
26. Taida Begic. *Applicable law in international investment disputes*. 2005. *ICSID Vol. 6*.
27. Vandeveld J. Kenneth, *The growth of bilateral investment treaties and their impact on foreign investment in developing countries // Int'l Law*. 1990.
28. Waibel M. *The backlash against investment arbitration: perceptions and reality*, 2010.
29. *WTO Appellate Body Report on United States - Import prohibition of certain shrimp products, WT/DS58/AB/RW (Oct. 22, 2001)*.

Burime nga interneti:

1. <http://www.pca-cpa.org>
2. www.wto.org
3. <http://icsid.worldbank.org>
4. www.icj-cij.org/docket/files/19/4761.pdf
5. http://icsid.worldbank.org/ICSID/Servlet?requestType=CasesRH&actionVal=showDoc&docId=DC1171_En&caseId=C5
6. https://icsid.worldbank.org/ICSID/StaticFiles/basicdoc/CRR_English-final.pdf
7. <http://www.investmenttreatynews.org/cms/news/archive/2010/03/10/icsid-tribunal-applies-ad-hoc-approach-to-confidentiality-in-arbitral-proceeding.aspx>
8. <http://icsid.worldbank.org/ICSID/Servlet?requestType=CasesRH&actionVal=show>

- Doc&docId=DC677_En&caseId=C140
9. <http://icsid.worldbank.org/ICSID/FrontServlet?requestType=CasesRH&actionVal=showDoc&docId=DC533&caseId=C148>
 10. <http://icsid.worldbank.org/ICSID/FrontServlet?requestType=CasesRH&actionVal=showDoc&docId=DC536&caseId=C15>
 11. <http://www.worldbank.org/afr/wps/wp62.pdf>
 12. http://icsid.worldbank.org/ICSID/FrontServlet?requestType=CasesRH&actionVal=showDoc&docId=DC569_En&caseId=C165
 13. www.iusct.org/general-declaration.pdf

Roli i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë ne interpretimin e rregullave të lëvizjes së lirë të personave

Sokol Bana PhD

Abstrakt

Lëvizja e lirë është një e drejtë themelore në Bashkimin Europian. E drejta e Bashkimit Europian dhe në këtë kuadër edhe lëvizja e lirë e shtetasve evropianë udhëhiqet nga disa parime shumë të rëndësishme që përbëjnë bazën e zhvillimit dhe funksionimit të Tregut të Përbashkët Evropian. Lëvizja e lirë si një nga katër liritë themelore që siguron tregu i përbashkët udhëhiqet nga parimi i respektimit dhe mbrojtjes të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ashtu siç do të trajtohet në këtë artikull, lëvizja e lirë është një ndër të drejtat e patjetërsueshme të njeriut, e cila në legjislacionin e BE-së ka marrë një dimension shumë më të gjerë e të avancuar. Gjykata e Drejtësisë ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm për afirmimin progresiv të lëvizjes së lirë të personave. Nëpërmjet një interpretimi gjithnjë në rritje të legjislacionit komunitar, Gjykata i ka dhënë një zgjerim fushës së aplikimit të dispozitave të Traktatit për lëvizjen e lirë të personave, duke hequr pothuajse plotësisht kufirin e parë që ia njihje këtë të drejtë vetëm një kategorie të ngushtë operatorësh ekonomikë.

***Fjalet Kyçe:** lëvizja e lirë, Bashkimin Europian, shtetas komunitarë, shtetas jo komunitarë, jurisprudenca e GEJD-së etj.*

1. Hyrje

Lëvizja e lirë është një e drejtë parashikon që çdo individ i një shteti, në cilin ky është rezident, mund të largohet nga shteti i tij, me dokumentacionin përkatës të udhëtojë sa herë që ai dëshiron dhe të mund të kthehet tek shteti i origjinës në çdo